



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.68

20 maj

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 115
datë 23.4.2009

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës Greke e Organizatës së Sigurimit të Kredive të Eksportit (ECIO)”

3085

Vendim i KM
nr.331, datë 25.3.2009

Për ndarjen në nivele, brenda kategorive, të personelit akademik, në institucionet e arsimit të lartë, emërtimin e renditjen e tyre, si dhe kriteret dhe kualifikimet për secilin vend pune

3087

Vendim i KM
nr.332, datë 1.4.2009

Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, të ndryshuar

3091

Vendim i KM
nr.333, datë 1.4.2009

Për disa shtesa në vendimin nr.1322, datë 1.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga autoriteti portual, Durrës Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të kinoklubit “Mujo Ulqinaku”, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.586, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror”

3092

Vendim i KM nr.334, datë 1.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.17, datë 13.1.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e afateve të përdorimit të armëve, të teknikës e të pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe të rregullave për trajtimin e tyre, pas heqjes nga armatimi dhe përdorimi”	3092
Vendim i KM nr.336, datë 1.4.2009	Për dhënie fondi ndihme, partisë “Rruga e lirisë”	3093
Vendim i KM nr.337, datë 1.4.2009	Për një shtesë në vendimin nr.296, datë 6.5.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit të strategjisë kombëtare të migracionit”, të ndryshuar	3093
Vendim i KM nr.338, datë 1.4.2009	Për lejimin e hyrjes dhe të qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të forcave ushtarake, holandeze e rumune, pjesëmarrëse në stërvitjen e përbashkët “Albanian lion-09”	3094
Vendim i KM nr.339, datë 1.4.2009	Për disa shtesa në vendimin nr.305, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të atashëve ushtarake, të ushtarakëve të forcave të armatosura, që shërbejnë në shtabet e NATO-s e në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, dhe të ushtarakëve shqiptarë, që shërbejnë pranë organizatave ndërkombëtare dhe në shtabet ndërkombëtare”	3094
Vendim i KM nr.343, datë 8.4.2009	Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse	3095
Vendim i KM nr.363, datë 1.4.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi në përdorim të komunës Topojë të qarkut Fierit	3099
Vendim i KM nr.364, datë 1.4.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Vreshtas të qarkut të Korçës	3100
Vendim i KM nr.365, datë 1.4.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Sinaballaj të qarkut të Tiranës	3101
Vendim i KM nr.367, datë 1.4.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kastriot të qarkut të Dibrës	3102
Vendim i KM nr.368, datë 1.4.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Novoselë të qarkut të Korçës	3103
Vendim i KM nr.369, datë 1.4.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “German 1, 2 dhe 3”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	3105

Vendim i KM nr.371, datë 8.4.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të një automjeti dhe dy trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë..	3105
Vendim i KM nr.372, datë 8.4.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të pesë autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	3106
Vendim i KM nr.373, datë 8.4.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të katër autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	3107
Vendim i KM nr.374, datë 8.4.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të tetë autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	3108
Vendim i KM nr.375, datë 8.4.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të disa trupave dhe automjeteve ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	3109
Vendim i KM nr.376, datë 8.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.1114, datë 30.7.2008 të këshillit të ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”	3110
Vendim i KM nr.379, 8.4.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë lekovik të qarkut të Korçës	3110
Vendim i KM nr.380, datë 8.4.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lopëz të qarkut të Gjirokastrës	3111
Vendim i KM nr.397, datë 22.4.2009	Për lirimin, mandatimin dhe rimandatimin e disa anëtarëve të këshillit kombëtar të kontabilitetit	3112
Vendim i KM nr.406, datë 22.4.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.42, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar	3113
Vendim i KM nr.417, datë 22.4.2009	Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për zgjedhësit pa pasaportë, të cilëve u duhet të udhëtojnë nga zonat e largëta për të aplikuar për letërnjoftim	3113
Vendim i KM nr.418, datë 27.4.2009	Për njohjen dhe përdorimin e letërnjoftimit si dokument identifikimi	3116
	Ndreqje gabimi	3118

LIGJ
Nr.10 115, datë 23.4.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCave DHE MINISTRISË SË EKONOMISË DHE FINANCave TË REPUBLIKËS GREKE E ORGANIZATËS SË SIGURIMIT TË KREDIVE TË EKSPORTIT (ECIO)”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës Greke e Organizatës së Sigurimit të Kredive të Eksportit (ECIO)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6156, datë 7.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCave E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MINISTRISË SË EKONOMISË DHE FINANCave TË REPUBLIKËS GREKE DHE
ORGANIZATËS SË SIGURIMIT TË KREDISË SË EKSPORTIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, këtu quhet “Pala Shqiptare” dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës Greke së bashku me Organizatën për Sigurimin e Kredisë së Eksportit këtu quhet “Pala Greke”, bien dakord për shlyerjen e borxhit që rrjedh nga marrëveshja ndërmjet Konsorciumit të Bankave Greke dhe Bankës Shtetërore të Shqipërisë, të nënshkruar në Athinë, më 24 qershor 1991, si më poshtë:

Neni 1

Borxhi total i Palës Shqiptare kundrejt Palës Greke arrin në 40 694 906,51 USD, i datës 30 prill 2008.

Neni 2

Periudha e shlyerjes së plotë i të gjithë borxhit është dhjetë (10) vjet dhe kështet përkatëse jepen në çdo gjashtë muaj.

Neni 3

Borxhi total duhet të paguhet në njëzet (20) kështe të barabarta gjysmëvjeçare prej 2 034 745,32 USD secili. Kësti i parë i kërkueshëm më 31 tetor 2008 paguhet jo më vonë se 31 mars 2009, pa kamatëvonesë. Kështet e tjera për vitet 2009 deri 2017 bëhen të kërkueshëm dhe të pagueshëm më 30 prill dhe 31 tetor për çdo vit përkatës. Kësti i fundit është i kërkueshëm dhe i pagueshëm më 30 prill 2018. Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë i bën pagesat në llogarinë e veçantë në GR 130100023000000002340396 “G.L.K. D25-Kefalaion Asfalisews Hrimatodotisewn ek Kafalaiwn i eggýisei toy ellinikoy Dimosioy” të Bankës së Greqisë, e hapur nga Pala Greke për këtë qëllim.

Neni 4

Interesi është i pagueshëm në fund të secilës prej 20 periudhave të njëpasnjëshme të interesit prej gjashtë muajsh secila. Llogaritja e interesit fillon më 1 maj 2008. Pagesa e parë e interesit bëhet jo më vonë se 31 mars 2009. Pagesat e tjera të interesit për vitet 2009 deri 2017 bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme më 30 prill dhe 31 tetor për çdo vit përkatës. Pagesa e fundit e interesit është e kërkueshme dhe e pagueshme më 30 prill 2018.

Neni 5

Interesi llogaritet në fund të çdo periudha gjashtëmuajore me një normë prej LIBOR gjashtëmuajor mbi gjendjen e shumës kryesore të pashlyer. Norma e zbatueshme e interesit bazohet në Normën e Ofertës të London Interbank USD (USD LIBOR), dy ditë pune para fillimit të periudhës pasuese të interesit. Pala Greke njofton me shkrim Ministrinë e Financave të Shqipërisë në lidhje me shumën e saktë të çdo pagese të interesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para datës së kërkueshme. Për pagesën e parë Pala Greke njofton me shkrim Ministrinë e Financave të Shqipërisë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas nënshkrimit të Marrëveshjes.

Neni 6

Nëse një pagesë nuk bëhet në kohën e duhur, zbatohet kamatëvonesa. Kamatëvonesa llogaritet me normën prej dy për qind (2%) mbi normën e interesit të parashikuar në nenin 5. Shuma e kamatëvonesave llogaritet mbi shumën e pagesës së vonuar, për periudhën nga data e kërkueshme deri në datën në të cilën faktikisht bëhet pagesa.

Neni 7

Korrespondenca në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje është në gjuhën angleze dhe drejtohet si më poshtë:

a) Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës Greke, Zyra e Përgjithshme e Llogarive të Shtetit, Drejtoria e 25-të.

Adresa: Panepistimiou 37,

101 65 Athens

Greece

Tel nr: +302103338910/2103338972/2103338912

Faks nr: +302103338959

b) Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.1

Tirana, Albania

Tel: +3554222 8405

Faks: +3554222 8494

Neni 8

Palët bien dakord të zgjidhin, nëpërmjet konsultimeve, çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga kjo marrëveshje. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet, ajo zgjidhet ekskluzivisht nga gjykatat e Londrës dhe zbatohet ligji anglez.

Neni 9

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e ratifikimit të saj, sipas rregullave të brendshme të ligjit të sëcilës palë kontraktuese dhe mund të ndryshohet në mënyrë të efektshme vetëm me shkrim.

Bërë në Tiranë më..... në tre (3) kopje origjinale në shqip, greqisht dhe anglisht, ku të gjitha janë njëloj autentike. Secila palë ka marrë një komplet kopjesh origjinale. Në rastin e mospërputhjes ndërmjet gjuhëve të ndryshme të versioneve të kësaj Marrëveshjeje, mbizotëron versioni në anglisht.

Për Ministrinë e Ekonomisë
dhe Financave të Republikës Greke
Ioannis Papathanasiou
Ministri i Ekonomisë dhe Financave
Për Organizatën e Sigurimit të Kredisë së
Eksportit
Ioannis Pantelidis
Drejtor i Departamentit Ligjor

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së
Shqipërisë
Ridvan Bode
Ministri i Financave

VENDIM **Nr.331, datë 25.3.2009**

PËR NDARJEN NË NIVELE, BRENDË KATEGORIVE, TË PERSONELIT AKADEMIK, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, EMËRTIMIN E RENDITJEN E TYRE, SI DHE KRITERET DHE KUALIFIKIMET PËR SECILIN VEND PUNE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 47, pika 3, e 93, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I **NDARJA NË NIVELE, BRENDË KATEGORIVE, TË** **PERSONELIT AKADEMIK**

1. Kategoritë e personelit akademik ndahen në nivele, të cilat emërtohen e renditen sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Ndarja në nivele bëhet për shpërndarjen e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas vendeve të punës, që ka çdo njësi, mbështetur në veprimtaritë, që do të zhvillojë dhe kualifikimin e kërkuar.

2. Kategoria “Profesor” përfshin personelin akademik, i cili është titullar lëndësh ose modulesh e udhëheqës i veprimtarisë së kërkimit shkencor dhe përbëhet, përkatësisht, nga nivelet a/1 “Profesori” dhe a/2 “Profesori i asociuar”,

2.1 Niveli a/1 “Profesori”:

a) i cili është titullar i disiplinave/moduleve, në programe studimi, kryesisht të ciklit të dytë e të tretë, dhe i komisioneve të provimeve, në të gjitha ciklet e studimeve, udhëheq studentët në

përgatitjen e tezave të diplomave, në të gjitha ciklet e studimeve, drejton hartimin e dokumentacioneve kryesore, shkollore dhe kurrikulare;

b) drejton veprimtaritë e kërkimit dhe të transferimit të teknologjive, drejton grupin kërkimor, udhëheq tezat e doktoratës, për përgatitjen e kërkuesve të rinj etj;

c) merr pjesë aktive në drejtimin dhe zhvillimin e institucionit të arsimit të lartë e të njësive të tij, si dhe jep ndihmesë profesionale, për çështjet e arsimit e të shkencës, në shkallë vendi.

2.2 Niveli a/1 kërkon personel akademik, me titullin “Akademik” ose “Profesor”, i cili e ushtron veprimtarinë mësimore e kërkuese në institucionet e arsimit të lartë.

2.3 Niveli a/2 “Profesori i asociuar”:

a) i cili është titullar i disiplinave/moduleve e i komisioneve të provimeve, në të gjitha ciklet e studimeve, udhëheq studentët në përgatitjen e tezave të diplomave të studimeve, të ciklit të parë dhe të dytë, merr pjesë në hartimin e dokumentacioneve kryesore, shkollore e kurrikulare, dhe në drejtimin e procesit mësimor;

b) kryen veprimtari të pavarura të kërkimit shkencor, të zhvillimit dhe transferimit të teknologjive e njohurive dhe jep ndihmesën e vet në përgatitjen e kërkuesve etj;

c) mund të jetë edhe udhëheqës i tezave të doktoratës, kur këshilli i profesorëve të fakultetit jep pëlqimin, mbështetur në veprimtarinë akademike të udhëheqësit dhe në natyrën e temës së disertacionit të doktoratës, që propozohet;

ç) merr pjesë në drejtimin dhe zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të njësive të tij, si dhe ofron ndihmesë profesionale, për çështjet e arsimit dhe shkencës, në shkallë vendi etj.

2.4 Niveli a/2 kërkon personel akademik, me titullin “Profesor i asociuar”, i cili e ushtron veprimtarinë mësimore e kërkuese në institucionet e arsimit të lartë.

3. Personeli akademik, me titullin “Profesor emeritus”, përbëhet nga personel akademik, i dalë në pension, me kontribute të spikatura në mësimdhënie, kërkim apo në shërbim të institucionit dhe që e ka fituar këtë titull, në përputhje me përcaktimet në aktet e tjera nënligjore. Ky personel ftohet në institucionet e arsimit të lartë për elemente të veçanta të veprimtarisë, të përmendura më sipër në këtë vendim, si detyra të nivelit a/1 e a/2.

4. Kategoria “Docentë” përfshin personelin akademik, që zhvillon, kryesisht, veprimtari mësimore dhe ka titullin “Docent” ose gradën shkencore “Doktor”. Kjo kategori përbëhet, përkatësisht, nga nivelet b/1 “Docenti”, b/2 “Lektori i parë”/ “Kërkuesi i parë”.

4.1 Niveli b/1 “Docenti” kryen këto veprimtari:

a) jep mësim, në mënyrë të pavarur, në të gjitha programet e studimit, të ciklit të parë dhe të dytë, si dhe, nën drejtimin e personelit akademik, të nivelit a/1 e a/2, në programet e studimit të ciklit të tretë. Ai mund të jetë anëtar në komisionet e provimeve, në të gjitha ciklet e studimeve, si dhe udhëheqës i studentëve në përgatitjen e tezave të diplomave, të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve;

b) harton programe mësimore të studimit të ciklit të parë, merr pjesë në hartimin e programeve mësimore studimi të ciklit të dytë e të tretë dhe për zhvillimin e teknikave e të teknologjive të reja në mësimdhënie etj;

c) merr pjesë në programe kërkimi, zhvillimi dhe transferimi të teknologjive e njohurive, në botime profesionale dhe të mësimdhënies etj;

c) merr pjesë në drejtimin dhe zhvillimin e institucionit të arsimit të lartë e të njësive të tij, në udhëheqje e këshillim karriere, për grupe studentësh, etj.

4.2 Niveli b/1 kërkon personel akademik me titullin “Docent”, që e ushtron veprimtarinë në institucionet e arsimit të lartë.

4.3 Niveli b/2 “Lektori i parë” / “Kërkuesi i parë” kryen këto veprimtari:

a) jep mësim, në mënyrë të pavarur, në programe të studimit, të ciklit të parë e të dytë, harton dokumentacionet e programeve të studimit e të programeve disiplinore etj.;

b) merr pjesë në programe e projekte kërkimore, të zhvillimit dhe të transferimit të teknologjive, në kërkim të pavarur, në botime shkencore dhe profesionale etj;

c) merr pjesë në drejtimin dhe zhvillimin e institucionit të arsimit të lartë e të njësive të tij në tutorët e këshillim karriere, për grupe studentësh etj.;

4.4 Niveli b/2 kërkon personel akademik, me gradën shkencore “Doktor”, që e ushtron veprimtarinë në fakultete, dhe quhet “Lektor i parë” ose në institute e qendra kërkimi dhe zhvillimi, dhe quhet “Kërkues i parë”.

4.5 Ky nivel zbatohet edhe për personelin akademik, të punësuar në drejtimet e studimeve universitare, në fushën e shëndetësisë, i cili ka kryer studimet specializuese afatgjata dhe ka, së paku, 2 vjet përvojë pune si specialist në fushën përkatëse.

5. Kategoria “Lektorë” përfshin personelin akademik, që zotëron një diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND) ose “Magistër”, ose ekuivalentin e këtyre kategorive, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në fushë të njëjtë ose të përafërt.

5.1 Kategoria “Lektorë” për fushat e krijimtarisë në arte përfshin edhe personelin akademik, që zotëron një diplomë të studimeve universitare, të modelit të vjetër, të ekuivalentuar sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin e tretë të nenit 89 të ligjit nr.9741, datë 24.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili, pas përfundimit të studimeve dhe në vazhdim dëshmon se ka një veprimtari të spikatur artistike, të certifikuar të tillë nga personalitetet e fushës dhe organet e autoritetet drejtuese të Akademisë së Arteve.

5.2 Kategoria “Lektorë” përbëhet nga niveli: c/1 “Lektori”/ “Kërkuesi”, i cili kryen këto veprimtari:

a) jep mësim në programe të studimit universitar të ciklit të parë dhe në programe të studimit jouniversitar, merr pjesë në hartimin e dokumentacioneve kurrikulare të programeve të studimit të ciklit të parë, nën drejtimin e personelit akademik, të niveleve a/1, a/2 dhe/ose b/1, b/2, si dhe në procese të tjera, të cilat përputhen me formimin e tij etj;

b) jep mësim nën drejtimin e personelit akademik, së paku, të një kategorie mbi të, në programet e studimit në ciklin e dytë (DND) ose, në mënyrë të pavarur, në MNP;

c) merr pjesë në projektet kërkimore të institucionit, në programet rajonale të zhvillimit dhe transferimit të teknologjive etj.;

ç) merr pjesë në komisione provimesh, në monitorime, tutorët dhe këshillim karriere, për studentë e grupe studentësh etj.

5.3 Niveli c/1 e ushtron veprimtarinë në fakultete, dhe quhet “Lektor” ose në institute e qendra kërkimi dhe zhvillimi, dhe quhet “Kërkues”.

6. Institucionet e arsimit të lartë mund të punësojnë edhe studentë, që janë në procesin e kryerjes së studimeve të doktoratës e të përgatitjes së disertacionit, për gradën shkencore “Doktor”, për të mbështetur profesorin udhëheqës të disertacionit në procesin mësimor. Kjo kategori nuk mund të vlerësohet personel akademik i brendshëm i institucionit. Ngarkesa mësimore e këtyre studentëve duhet të jetë jo më shumë se 25 për qind e asaj të përcaktuar për nivelin e lektorit, me qëllim që të mos ta pengojë atë në përgatitjen e disertacionit.

7. Personeli akademik, i punësuar në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim, përparon në karrierë, mbështetur në kualifikimet dhe në vlerësimet pozitive në punë.

7.1 Kalimi nga një kategori në një tjetër bëhet me kërkesë, me shkrim, dhe përkundrejt procedurave të konkurrimit për atë vend pune.

7.2 Kalimi nga një nivel në një nivel më të lartë, brenda kategorisë, dhe nga një kategori më e ulët në një tjetër më të lartë, të personelit akademik, bëhet kur institucioni ka vend të lirë për këtë nivel dhe kandidati ka kualifikimet e nivelit përkatës dhe ka marrë vlerësim pozitiv për punën e bërë nga këshilli i fakultetit. Këto vlerësime kryhen çdo 2 (dy) vjet.

KREU II

RIORGANIZIMI I PERSONELIT AKADEMIK ME VENDET E REJA TË PUNËS, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Personeli akademik, i cili në vitin akademik 2008-2009 nuk do të ketë shkallën e kualifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim, do të mbajë një vend pune, që i afrohet më shumë kualifikimeve të tij, me detyrimin që, brenda një periudhe 5-vjeçare, nga hyrja në fuqi e ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, të ndryshuar, të kualifikohet, sipas kërkesave të vendit të punës.

1.1 Personeli akademik, i punësuar aktualisht në institucionet publike të arsimit të lartë, ka përparësi ndaj kërkesave të kandidatëve të tjerë, në kuotat, që miratohen për programe studimi “Master i nivelit të dytë” dhe doktoratë.

2. Institucionet e arsimit të lartë nuk mund të klasifikojnë në kategoritë “Profesorë” dhe “Docentë” anëtarë të personelit akademik, të punësuar në institucion, të cilët nuk përmbushin kriteret përkatëse të kualifikimit, shkencor e pedagogjik, të vendit të punës.

3. Në nivelin c/1 “Lektori” apo “Kërkuesi” kalojnë anëtarët e personelit akademik, me një diplomë të marrë në studime të thelluara pasuniversitare, të ekuivalentuara, sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin e tretë të nenit 89 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3.1 Në nivelin c/1 kalojnë edhe anëtarët e personelit akademik, që kanë një diplomë të nivelit të dytë, diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë të studimeve universitare, të modelit të vjetër, të ekuivalentuar, sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin e dytë të nenit 89 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, të ndryshuar, maksimumi deri në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu.

4. I gjithë personeli akademik me titullin “Profesor”, aktualisht i punësuar në institucionet publike të arsimit të lartë, gëzon të drejtën e vendit të punës të nivelit a/1.

4.1 Vendet e punës, të zëna nga personeli akademik, që, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë arritur moshën 60 vjeç për meshkujt dhe 55 vjeç për femrat, nuk shpallen e rishpallen për konkurrim. Ky personel ka të drejtë ta ruajë, deri në daljen në pension, vendin e punës, në kategorinë dhe nivelin që do të klasifikohet, në bazë të këtij vendimi, pa zbritur nga paga që ka gëzuar deri në atë çast.

4.2 Për të tërhequr personel akademik me kualifikimin e nevojshëm, institucionet e arsimit të lartë duhet të shpallin, para fillimit të çdo viti akademik, të gjitha vendet e punës, të zëna nga personeli akademik, i punësuar me kontratë të përkohshme, por që nuk përmbush kriteret përkatëse të kualifikimit, shkencor e pedagogjik, të vendit të punës.

5. Vendet e lira të punës, në institucionet publike të arsimit të lartë, shpallen, si rregull, në muajin qershor të çdo viti.

6. Në kuadër të strategjisë për thithjen e trurit, “Brain gain”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë parashikojnë të kenë, çdo vit, kuota për vende të lira pune, për të emëruar ose riemëruar në këto institucione, në çdo kohë, personel akademik, i cili:

6.1 ka përfunduar me vlerësim, me notë mbi mesataren, studimet e doktoratës dhe ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor” ose “Ph.D.”, në universitete të huaja, të akredituara nga agjenci ose organizma, të njohura në shkallë ndërkombëtare;

6.2 pas përfundimit të studimeve të doktoratës, ka qenë i punësuar në profesion në një universitet perëndimor a qendër kërkimore;

6.3 pas studimeve të doktoratës në Shqipëri, ka përfunduar studime postdoktorale, të paktën njëvjeçare, në një universitet a qendër kërkimore perëndimore të akredituar nga agjenci, të njohura në shkallë ndërkombëtare.

7. Personeli akademik i kategorisë “a” (pika 2, kreu I) punësohet me kontratë, me afat të pacaktuar, në institucion.

8. Ministri i Arsimit dhe Shkencës nxjerr udhëzim për kategoritë e personelit ndihmës, mësimor e shkencor, të institucioneve të arsimit të lartë dhe përshtatjen e tyre me kategoritë e personelit akademik.

9. Institucionet private të arsimit të lartë e kryejnë vetë riorganizimin e personelit akademik, por duhet, në çdo rast, të respektojnë kriteret dhe kualifikimet e kërkuara për secilin vend pune, në institucionet e arsimit të lartë, të përcaktuara në kreun I të këtij vendimi. Ato duhet ta punësojnë personelin akademik, në përputhje me nivelin e arsimit, që ofrojnë në institucion.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.332, datë 1.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1, DATË 7.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAJISJEN, PËR HERË TË PARË, ME LETËRNJOFTIM, TË SHTETASVE SHQIPTARË DHE PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE E TË MASAVE SHTRËNGUESE PËR ATA, QË NUK APLIKOJNË BRENDË KËTYRE AFATEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 179 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 1 e 3, pika 2, të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”, dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 4, afati “15 prill 2009” bëhet “15 maj 2009”.

2. Pika 4/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4/1 Procedura e aplikimit për shtetasit e tjerë, të cilët disponojnë pasaportë, fillon në datën 1 maj 2009. Bëjnë përjashtim nga ky rregull shtetasit, që kanë aplikuar përpara datës 31 janar 2009, për të cilët pajisja do të vazhdojë rregullisht:

a) Nga data 1 prill 2009 deri më 1 maj 2009, shtetasit, që disponojnë pasaportë, nuk do të lejohen të aplikojnë për pajisjen me letërnjoftim.

b) Në njësitë e qeverisjes vendore, ku ende nuk ka filluar procesi i aplikimit për pajisjen me letërnjoftim, procedura e aplikimit për shtetasit, që disponojnë pasaportë, do të fillojë më 1 qershor 2009.”.

3. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1 Nëse nga grupet e monitorimit vërehen, gjatë aplikimit, shkelje të afateve e të procedurave, të parashikuara në këtë vendim, nga punonjësit përkatës të zyrës së gjendjes civile, për shtetasit, që disponojnë pasaportë, kostoja e aplikimit do t’i ngarkohet punonjësit përgjegjës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.333, datë 1.4.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.1322, DATË 1.10.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA AUTORITETI PORTUAL, DURRËS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS TË KINOKLUBIT “MUJO ULQINAKU”, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.586, DATË 10.9.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË INVENTARËVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT U KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHOQËRIVE ANONIME DHE NDËRMARRJEVE TË SISTEMIT TË TRANSPORTIT DETAR DHE AJROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 10, 13 e 14 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1322, datë 1.10.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1 të këtij vendimi, pas togfjalëshit “...Mujo Ulqinaku...” shtohen fjalët “...përfshirë truallin nën godinë dhe përreth saj me sipërfaqe të përgjithshme 2 479 (dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) m²...”.

2. Në pikën 2 të këtij vendimi, pas fjalëve “...me numër rendor 21...”, shtohen “... dhe për sipërfaqen 2 479 (dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) m² nga sipërfaqja e përgjithshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.334, datë 1.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.17, DATË 13.1.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E AFATEVE TË PËRDORIMIT TË ARMËVE, TË TEKNIKËS E TË PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE TË RREGULLAVE PËR TRAJTIMIN E TYRE, PAS HEQJES NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 7 e 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr.17, datë 13.1.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Armët, mjetet dhe pajisjet e Forcave të Armatosura hiqen nga përdorimi me urdhër të autoritetit përkatës, sipas pikës 5 të këtij vendimi, kur:

- a) janë plotësuar vitet e përdorimit, sipas tabelave nr.1 e nr.2;
- b) janë plotësuar kilometrat e përshkruar, sipas tabelës nr.1;
- c) janë plotësuar orët e punës, sipas tabelës nr.1;

- ç) është plotësuar numri i të shtënave, sipas tabelës nr.2;
d) janë tepër dhe jashtë nevojave të Forcave të Armatosura, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve (TOP);
dh) janë të papërdorshme, si rezultat i dëmtimit të elementeve fizike e kimike ose e humbjes së vetive tekniko-luftarake.”
2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.336, datë 1.4.2009

PËR DHËNIE FONDI NDIHME, PARTISË “RRUGA E LIRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë “Rruga e Lirisë” t’i jepet një fond prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për vitin 2009.
3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.337, datë 1.4.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.296, DATË 6.5.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË MIGRACIONIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 2 të vendimit nr.296, datë 6.5.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për bashkërendimin e punës për zbatimin e planit kombëtar të veprimit të strategjisë kombëtare të migracionit, ngre Komitetin Teknik për Migracionin, në përbërje të të cilit të përfshihen përfaqësues të nivelit të lartë drejtues, të ministrive e institucioneve të ngarkuara për zbatimin e këtij plani.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.338, datë 1.4.2009

PËR LEJIMIN E HYRJES DHE TË QËNDRIMIT NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË FORCAVE USHTARAKË, HOLANDEZE E RUMUNE, PJSËMARRËSE NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT “ALBANIAN LION-09”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e hyrjes dhe të qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të 310 (treqind e dhjetë) forcave ushtarake, holandeze e rumune, pjesëmarrëse në stërvitjen e përbashkët, të koduar “Albanian Lion-09”, që do të zhvillohet në rajonet e gadishullit të Karaburunit, ishullit të Sazanit, bazës detare të Pashalimanit dhe të gjirit të Vlorës, nga data 6 prill 2009 deri më 21 prill 2009.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.339, datë 1.4.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.305, DATË 12.3.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ATASHEVE USHTARAKË, TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, QË SHËRBEJNË NË SHTABET E NATO-S E NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-S, DHE TË USHTARAKËVE SHQIPTARË, QË SHËRBEJNË PRANË ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET NDËRKOMBËTARE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.305, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të shkronjës “gj” të pikës 1 të shtohen fjalët “... zyrë dhe kancelari.”
2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1 Atashetë ushtarake dhe përfaqësitë ushtarake kanë të drejtë të prokurojnë, brenda fondeve buxhetore, të vëna në dispozicion për kryerjen e shpenzimeve, të përmendura në shkronjat “e”, “gj”, “h” e “i” të pikës 1 të këtij vendimi, dhe janë të detyruara të zbatojnë rregullat e prokurimit publik, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Kur përfaqësia nuk disponon numrin e nevojshëm të personelit, për kryerjen e procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit për prokurimin publik, dërgon ofertat në Ministrinë e Mbrojtjes, e cila bën përzgjedhjen dhe miraton ofertën më të përshtatshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.343, datë 8.4.2009

PËR MËNYRAT DHE PROCEDURAT E RAPORTIMIT TË AUTORITETEVE
LICENCUESE DHE/OSE MBIKËQYRËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, pika 5, e 28, pika 1, të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në mbështetje të nenit 24 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, autoritete licencuese dhe mbikëqyrëse janë:

- a) Banka e Shqipërisë për subjektet:
 - i) Bankat tregtare;
 - ii) Institucionet financiare jobankare;
 - iii) Zyrat e këmbimeve valutore;
 - iv) Shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre;
 - v) Shërbimet postare, që kryejnë shërbime pagesash;
 - vi) Çdo person, fizik ose juridik, i cili merret me sigurimin dhe administrimin e parasë fizike ose të letrave me vlerë, lehtësisht të konvertueshme, në emër të personave të tretë;
 - vii) Bizneset e metaleve dhe të gurëve të çmuar;
 - viii) Çdo person, fizik ose juridik, i cili merret me marrëveshjet dhe garancitë financiare;
 - ix) Çdo person, fizik ose juridik, që emeton apo menaxhon mjetet e pagesës a të parasë, ose kryen transferimin e vlerës (karta debiti dhe krediti, çeqe, çeqe udhëtari, urdhra pagese dhe urdhërpagesa bankare, para elektronike ose instrumente të tjera të ngjashme);
- x) Çdo person, fizik ose juridik, përveç atyre të përcaktuar më sipër, të cilët merren me:
 - qiratë financiare;
 - huatë financiare;
 - këmbimin e parasë fizike.
- b) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për subjektet:
 - i) Çdo person, fizik ose juridik, i cili merret me administrimin e aseteve të të tretëve, me drejtimin e veprimtarive të lidhura me to;
 - ii) Bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shtëpi brokerimi etj.), që ushtrojnë veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër, që ka lidhje me tregtimin e titujve;
 - iii) Shoqëritë, që merren me sigurimin e jetës ose risigurimin, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit.
- c) Ministria e Financave për:
 - i) Autoritetin shtetëror, përgjegjës për administrimin dhe shitjen e pronës publike dhe çdo person tjetër juridik, publik, që kryen veprime juridike për tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronës shtetërore ose që kryen evidencimin, transferimin apo tjetërsimin e pronës shtetërore;

- ii) Organet doganore;
- iii) Organet tatimore.
- ç) Njësia e mbikëqyrjes së lojërave të fatit, në Ministrinë e Financave, për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet, të çfarëdo forme.
- d) Ministria e Drejtësisë për noterët.
- dh) Dhoma Kombëtare e Avokatisë për avokatët.
- e) Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për:
 - i) Agjentët e pasurive të paluajtshme dhe ekspertët e vlerësimit të pasurive të paluajtshme;
 - ii) Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale;
 - iii) Çdo person, fizik ose juridik, i cili merret me:
 - tregtimin e mjeteve motorike;
 - veprimtaritë e spedicionit dhe të transportit;
 - agjencitë e udhëtimit;
 - shoqëritë e ndërtimit.
- ë) Bordi i Mbikëqyrjes Publike për:
 - i) IEKA-në - Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
 - ii) IKM-në - Instituti i Kontabilistëve të Miratuar;
 - iii) SHKFSH-në - Shoqata e Kontabilistëve e Financierëve Shqiptarë;
 - iv) Ekspertët kontabël të autorizuar, të pavarur;
 - v) Kontabilistët e miratuar, të pavarur, dhe zyrat e konsulencës financiare.
- f) Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për shitblerjen e veprave të artit apo shitblerjen me ankand të sendeve me vlerë 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose më shumë.
- g) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për organizatat jofitimprurëse.

2. Në mbështetje të pikës 2 të nenit 24 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse mbikëqyrin, nëpërmjet inspektimeve, përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me detyrimet e përcaktuara në nenet 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 e 12 të ligjit të lartpërmendur.

3. Organet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse raportojnë tek autoriteti përgjegjës për çdo dyshim të bazuar, për burimin ose origjinën e kapitalit, natyrën e veprimit financiar, pavarësisht nga vlera e përcaktuar në nenin 12 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, në rastet kur:

a) kanë dyshime të bazuara në fakte e rrethana konkrete, që mund të lidhen me parregullsi, në dokumentacionin identifikues dhe justifikues të burimit të ligjshëm të kapitaleve me ato reale;

b) vërejnë mosjustifikim të pasurisë apo të parave të deklaruara, nga pikëpamja ekonomike ose ligjore;

c) kanë informacione, sinjalizime e të dhëna se paratë ose pasuritë e depozituara për licencim rrjedhin nga vepra penale ose janë të përziera me para a pasuri të tilla, apo kur dyshojnë se veprimtaria, që kërkohet të licencohet, do të ngrihet për të realizuar ose mbështetur pastrimin e parave;

ç) organet licencuese dhe mbikëqyrëse duhet ta njoftojnë autoritetin përgjegjës në të njëjtën mënyrë, në çdo rast kur kanë të dhëna apo dyshime për implikime ose qëllime, që vërtetojnë se veprimtaria do të përdoret për të mbështetur, lehtësuar, ruajtur, nxitur ose fshehur aktet terroriste apo do të financojnë terrorizmin;

d) kanë dyshime të tjera, të bazuara në gjendjen ose rrethanat, të cilat nuk janë parashikuar më lart.

4. Autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse i raportojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë nga çasti i konstatimit të çdo dyshimi, marrjen e çdo informacioni ose të dhëne, që lidhet me pastrim parash ose financim terrorizmi, për veprimtaritë në juridiksionin e tyre.

5. Mënyra e raportimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave bëhet me anë të formularit të raportimit të veprimtarisë së dyshimtë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si aneksi I “Formulari i raportimit të veprimtarisë së dyshimtë nga autoritetet licencuese dhe mbikëqyrëse”, shoqëruar nga instruksionet për plotësimin e tij.

6. Autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse, të cilat, në mirëbesim, raportojnë ose japin informacion, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, janë të përjashtuara nga përgjegjësia penale, civile ose administrative për nxjerrjen e sekretit profesional.

7. Autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse u ndalohet ta informojnë klientin ose çdo person tjetër për procedurat e verifikimit të rasteve të dyshimta, si dhe për çdo raportim në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

8. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet dy institucioneve kryhet në bazë të konfidencialitetit të ndërsjellë.

9. Autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse duhet t’u kthejnë përgjigje kërkesave të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, brenda dhe jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së kërkesës për informacion.

10. Në raste urgjente, autoriteti përgjegjës u drejton autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse kërkesë verbale, e cila dokumentohet me shkrim brenda tri ditëve pune.

11. Dokumentacioni i identifikimit i të gjithë personave fizikë apo juridikë, që do të licencohen, ruhet për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënieve, juridike e civile, me ta.

12. Autoriteti licencues dhe/ose mbikëqyrës, me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, mund ta kufizojë, ta pezullojë ose ta revokojë licencën e një subjekti:

a) kur vëren ose kur ka fakte për të besuar se subjekti është i përfshirë në pastrimin e parave apo në financimin e terrorizmit;

b) kur subjekti, në mënyrë të përsëritur, kryen njërën ose disa nga kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 27 të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, dhe në aktet nënligjore.

13. Autoriteti licencues dhe/ose mbikëqyrës shqyrton kërkesën e autoritetit përgjegjës, bazuar në dokumentacionin shoqëruar, në të cilin paraqiten të dhëna ose dyshime, të bazuara në rrethana dhe fakte konkrete, sipas pikës 1 të këtij neni. Autoriteti licencues dhe/ose mbikëqyrës vendos për pranimin ose refuzimin e saj, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat, ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e tij dhe të subjekteve të licencuara e të mbikëqyrura prej tij.

14. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse për zbatimin e këtij vendimi dhe plotësimin e formularit të raportimit (aneksi I).

15. Raportimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave do të bëhet vetëm në përputhje me standardet e përcaktuara në dispozitat e këtij vendimi.

16. Udhëzimi nr.3, datë 18.3.2004 i Këshillit të Ministrave “Për formatet dhe procedurat e identifikimit dhe të raportimit nga organet, që licencojnë personat, fizikë dhe juridikë, në funksion të procesit të parandalimit të pastrimit të parave”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINSISTRI
Sali Berisha

**FORMULAR I RAPORTIMIT TE AKTIVITETIT TE DYSHIMTE NGA AUTORITETET
LICENSUESE DHE/OSE MBIKËQYRESE**

Aneksi I

PJESA I PERSONI FIZIK DHE JURIDIK I LICENSUAR DHE/OSE MBIKËQYRUR

1. a. Emri _____ b. Atësia _____ c. Mbiemri _____ ç. Emërtimi i Shoqërisë _____			
2 Statusi: a. ☐ Individ b. ☐ Person Fizik Tregtar c. ☐ Person Juridik d. ☐ Përfaqësues Ligjor			
3. Punësimi/Institucioni: _____		4. Profesionit: _____	
5. Dokumenti i Identifikimit dhe Numri: _____			
Datëlindja _____		Vendlindja _____	
Numri i Identifikimit të Personit të Tatuashëm (NIPT): _____			
Adresa: _____			

PJESA II INFORMACION MBI TRANSAKSIONIN/ET DHE AKTIVITETIN E DYSHIMTE

1. Numri dhe data e licenses: _____	
2. Lloji i transaksionit: _____	
3. Qëllimi i transaksionit: _____	
4. Shuma e përfshirë në transaksion: _____	5. Zgjidhni monedhën: ☐ LEK ☐ EUR ☐ USD ☐ Tjetër
6. Data e transaksionit: _____	7. Burimi i deklaruar i fondeve: _____
8. Mënyra e pagesës: _____	_____
9. Arsyeja e dyshimit: _____	_____
_____	_____
_____	_____

PJESA III INFORMACION PËR SUBJEKTIN RAPORTUES

1. Organi Licenses/Mbikeqyres _____	2. Personi Përgjegjes : _____
3. Numër telefoni: _____	4. Adresë e-mail (i): _____
2. Adresa: _____	

Ky formular dërgohet menjëherë tek “Autoriteti përgjegjës” për çdo dyshim, informacion ose të dhënë që lidhet me pastrim parash ose financim terrorizmi, për veprimtaritë nën juridiksionin e tyre. Ky formular të shoqërohet dhe me një shpjegim të hollësishëm ku të sqarohen të gjitha elementet e dyshimit.

VENDIM
Nr.363, datë 1.4.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI NË PËRDORIM TË
KOMUNËS TOPOJË TË QARKUT FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Topojë të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 48 (dyzet e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 253 (dyqind e pesëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Topojë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Topojë		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
13-19	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
20-35	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore sportive.	Në pronësi
42,43	Shërbim funeral.	Në pronësi
36-41, 144-163	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje).	Në pronësi
173-175	Furnizim me ujë të pijshëm	Në pronësi
44-79	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
80,83,86,90	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
253 (pronë shtesë)	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
81,82,84,85,87,88,89,91,134-136 (vetëm kanale të treta)	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive, kanale të treta).	Në pronësi

VENDIM
Nr.364, datë 1.4.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS VRESHTAS TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Vreshtas të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 362 (treqind e gjashtëdhjetë e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Vreshtas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Vreshtas

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
197, 215,216,229	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
10-18	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
19-22 (Duke përjashtuar dhomën e privatizuar)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.	Në pronësi
31-42	Varrezat publike	Në pronësi
43-86	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
273-292	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
293-296	Prona që përdoren në fushën e furnizimit me ujë.	Në pronësi
160-191,198-207,219-227	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
23-30, 87-159	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi

257-262	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
263-267,317,330,338,356	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	Në pronësi

VENDIM
Nr.365, datë 1.4.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SINABALLAJ TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Sinaballaj të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Sinaballaj të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.101, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Sinaballaj të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Sinaballaj për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Sinaballaj

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
8-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
11-24	Varrezat publike	Në pronësi
25-37	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim

38-45	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
170-171, 174-198	Infrastrukturë (sheshe lulishte dhe shërbime publike), rrugë vendore	Në pronësi
201,204	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta)	Në pronësi
236-256	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

VENDIM
Nr.367, datë 1.4.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS KASTRIOT TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Kastriot të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kastriot të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.719, datë 30.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kastriot të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kastriot për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
11-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
14-23	Varrezat publike	Në pronësi
24-25	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
27-43 (vetëm trojet e lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
27-43 (vetëm sheshet)	Infrastrukturë (sheshe lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
44,45,47,48,50,51,53,54, 56,57,59,60,61,63,64,66,67,69, 70,72,73,75,76,78,79,81,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
46,49,52,55,58,62,65,68,71 74,77,80,82	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
155-182	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik.	Në pronësi
183-193	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM**Nr.368, datë 1.4.2009**

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS NOVOSELË TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Novoselë të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Novoselë të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.1235, datë 10.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Novoselë të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Novoselë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Novoselë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
249	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
250-258	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
259-266	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
267-270	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
271-273	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
274-290	Varreza publike	Në pronësi
292-294	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik.	Në pronësi
295,296,298,300,301,302,304,305,306,308,310,311,313,315,317,319	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
297,299,303,307,309,312,314,316,318,320	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
321-341	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
372-405	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
427-439	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi

VENDIM
Nr.369, datë 1.4.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “GERMAN 1, 2 DHE 3”, DHE MIRATIMIN E
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “German 1, 2 dhe 3” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimi i bonusit prej 2 për qind të pikëve, për rezultatin teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “SIGERS” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “German 1, 2 dhe 3”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.371, datë 8.4.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË NJË AUTOMJETI DHE DY TRUPAVE
USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 9 prill 2009, të 1 (një) automjeti dhe 2 (dy) trupave ushtarake italiane.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Autokolonat italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.372, datë 8.4.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË PESË AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 11 prill 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 20 (njëzet) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 22 (njëzet e dy) trupa.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 11 prill 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) automjete dhe 29 (njëzet e nëntë) trupa.

4. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 11 prill 2009, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 30 (tridhjetë) trupa.

5. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 11 prill 2009, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 13 (tremëdhjetë) automjete dhe 27 (njëzet e shtatë) trupa.

6. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

7. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit

3106

shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

8. Autokolonat italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.373, datë 8.4.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË KATËR AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 12 prill 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 20 (njëzet) automjete dhe 42 (dyzet e dy) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 12 prill 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 20 (njëzet) automjete dhe 43 (dyzet e tre) trupa.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 12 prill 2009, të 1 (një) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 20 (njëzet) automjete dhe 42 (dyzet e dy) trupa.

4. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 12 prill 2009, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 9 (nëntë) automjete dhe 25 (njëzet e pesë) trupa.

5. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

6. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

7. Autokolonat italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.374, datë 8.4.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË TETË AUTOKOLONAVE USHTARAKE
ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 14 prill 2009, të 8 (tetë) autokolonave ushtarake italiane, si më poshtë vijon:

- autokolona e parë, 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete dhe 41 (dyzet e një) trupa;
- autokolona e dytë, 18 (tetëmbëdhjetë) automjete dhe 41 (dyzet e një) trupa;
- autokolona e tretë, 17 (shtatëmbëdhjetë) automjete dhe 35 (tridhjetë e pesë) trupa;
- autokolona e katërt, 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 29 (njëzet e nëntë) trupa;
- autokolona e pestë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 39 (tridhjetë e nëntë) trupa;
- autokolona e gjashtë, 10 (dhjetë) automjete dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) trupa;
- autokolona e shtatë, 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 23 (njëzet e tre) trupa;
- autokolona e tetë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 33 (tridhjetë e tre) trupa.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Autokolonat italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.375, datë 8.4.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DISA TRUPAVE DHE AUTOMJETEVE
USHTARAKE SLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 20 prill 2009, të 1 (një) automjeti dhe 5 (pesë) trupave ushtarake slovene.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 20 prill 2009, të 2 (dy) automjeteve dhe 7 (shtatë) trupave ushtarake slovene.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 30 prill 2009, të 2 (dy) automjeteve dhe 9 (nëntë) trupave ushtarake slovene.

4. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 30 prill 2009, të 1 (një) automjeti dhe 3 (tre) trupave ushtarake slovene.

5. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për trupat dhe automjetet tranzituese sipas pikës 1 dhe 3 të këtij vendimi është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

6. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për trupat dhe automjetet tranzituese sipas pikës 2 dhe 4 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

7. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

8. Automjetet dhe trupat ushtarake slovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.376, datë 8.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, NR.9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 9 të kreut IV “Procedurat për regjistrim” të vendimit nr.1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shprehja “... jo më shumë se një muaj për një person...” bëhet “... jo më shumë se tre muaj për një person.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.379, 8.4.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË LESKOVIK TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Leskovik të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 420 (katërqind e njëzet).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Leskovik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1,2,3,4,5,6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
51, 52-60	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
398	Shërbim funeral	Në pronësi
69-150 61-64,397	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
151-396	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje).	Në përdorim
31, 32,33	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën sociale.	Në pronësi
12,13,14	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
15,16,17,18	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive)	Në pronësi

VENDIM**Nr.380, datë 8.4.2009**

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS LOPËZ TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Lopëz të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Lopëz të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.38, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Lopëz të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Lopëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Sali Berisha**

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
10-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën shëndetit publik.	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
21-38	Varrezat publike	Në pronësi
39-40	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive administrative	Në pronësi
41-168	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
169-172,174-176,178-180, 182-184, 186-188	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
173,177,181,185,189 278,279,285,286 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
311-462	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
463-475	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizime	Në pronësi

VENDIM
Nr.397, datë 22.4.2009

PËR LIRIMIN, MANDATIMIN DHE RIMANDATIMIN E DISA ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe tënenit 20 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lirimin nga funksioni, për shkak të përfundimit të mandatit, të dy anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

- z.Thanas Dhimarko;
- z.Sherif Bundo.

2. Mandatimin si anëtarë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të:

- z.Agim Binaj, propozuar nga Unioni i Dhomave të Tregtisë;
- z.Nezir Haldeda, propozuar nga Ministri i Financave.

3. Rimandatimin si anëtarë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të:

- z.Sotiraj Dhamo, propozuar nga Instituti i Kontabilistëve të Miratuar;
- z.Ylber Bezo, propozuar nga Ministri i Financave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.406, datë 22.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.42, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE
PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT,
KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË USHTROJNË
VEPRIMTARI NDËRTIMI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5 e kreut IX “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, e rregullores, që i bashkëlidhet vendimit nr.42, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Rikategorizimi dhe riklasifikimi i licencave të dhëna para hyrjes në fuqi të vendimit nr.42, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, përfundon 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.417, datë 22.4.2009

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË UDHËTIMIT PËR ZGJEDHËSIT PA
PASAPORTË, TË CILËVE U DUHET TË UDHËTOJNË NGA ZONAT E LARGËTA PËR
TË APLIKUAR PËR LETËRNJOFTIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare, për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite dhe “Fondi Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, t’i shtohet fondi 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për zgjedhësit pa pasaportë, që aplikojnë për letërnjoftim, në komunat e përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit vetëm për personat pa pasaportë, që banojnë në fshatrat me mbi 5 km larg qendrës së aplikimit. Kryetarët e komunave, të përfshirë në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të evidentojnë listën me emrat e shtetasve për çdo fshat, që plotësojnë kushtet e mësipërme dhe që nuk kanë pasaportë.

3. Çdo zgjedhës pa pasaportë, që vjen për të aplikuar për letërnjoftim, pas aplikimit merr nga zyra e financës së komunës pagesën për transportin, por, në çdo rast, jo më shumë se 100

(njëqind) lekë kur qendra e aplikimit ndodhet në të njëjtën komunë, dhe jo më shumë se çmimi publik, i miratuar nga prefekti përkatës dhe i bërë publik për banorët jo më vonë se data 8.5.2009.

4. Kryetarët e komunave të evidentojnë mjetet e transportit të udhëtarëve dhe të kujdesen që, gjatë kohës së aplikimit për letërnjoftim, të ketë mjete transporti në të gjitha fshatrat, që ndodhen më shumë se 5 km larg dhe ku rrjeti rrugor e lejon.

5. Në fund të çdo muaji kryetari paraqet në prefekturë listën e personave të trajtuar dhe shumën përkatëse, të financuar.

6. Prefektët autorizojnë financimin e fondeve pas pranimit dhe miratimit të dokumenteve të mësipërme.

7. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të vitit 2009.

8. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë udhëzimin për procedurat dhe detyrat përkatëse, që i duhet të zbatojnë prefektët dhe kryetarët e komunave për përmbushjen e kësaj detyre.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, prefektët dhe kryetarët e njësive të përfshirë në listë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

INFORMACION MBI VOTUESIT PA PASAPORTË PËR ZYRAT E PAHAPURA DHE ZYRAT E MBYLLURA

Nr .	Qarku	Rrethi	Kodi ZGJC	Komuna	Kodi ZGJC ku shkon	Komuna ku shkon	Votues pa pasaportë
1	Berat	Berat	012	Terpan			618
2	Berat	Skrapar	024	Cepan			249
3	Berat	Skrapar	025	Gjërbes			619
4	Berat	Skrapar	027	Potom			318
5	Berat	Mbyllur	030	Zhepe	025	Gjërbes	165
6	Berat	Mbyllur	029	Vendreshe	023	Bogovë	134
7	Berat	Mbyllur	026	Leshnje	028	Qendër	136
8	Dibër	Dibër	036	Kala e Dodës			990
9	Dibër	Dibër	038	Lurë			464
10	Dibër	Dibër	039	Luzni			1058
11	Dibër	Dibër	045	Zall Dardhë			911
12	Dibër	Mat	058	Ulëz			471
13	Dibër	Bulqizë	064	Martanesh			651
14	Dibër	Mbyllur	046	Zall Rec	045	Zall Dardhë	298
15	Dibër	Mbyllur	055	Macukull	050	Derjan	307
16	Dibër	Mbyllur	063	Klenjë	065	Ostren	187
17	Elbasan	Elbasan	101	Funarë			729
18	Elbasan	Gramsh	129	Tunjë			561
19	Elbasan	Librazhd	147	Stravaj			824
20	Elbasan	Mbyllur	113	Rrase	98	Belsh	356
21	Elbasan	Mbyllur	103	Gracen	99	Bradashesh	475
22	Elbasan	Mbyllur	118	Zavalin	105	Gjinar	407
23	Elbasan	Mbyllur	127	Skënderbegas	120	Gramsh	240
24	Elbasan	Mbyllur	123	Kushove	120	Gramsh	178
25	Elbasan	Mbyllur	126	Porocan	125	Pishaj	334
26	Elbasan	Mbyllur	128	Sult	125	Pishaj	208
27	Elbasan	Mbyllur	132	Karinë	131	Peqin	265
28	Elbasan	Mbyllur	148	Streblevë	138	Librazhd	171
29	Elbasan	Mbyllur	124	Lenie	121	Kotovjat	118

30	Fier	Mallakastër	191	Fratar			1270
31	Fier	Mallakastër	192	Greshicë			385
32	Fier	Mbyllur	195	Ngracan	190	Aranitas	180
33	Fier	Mbyllur	197	Selite	191	Fratar	261
34	Gjirokastrë	Tepelenë	216	F.Memaliaj			443
35	Gjirokastrë	Përmet	226	Ballaban			364
36	Gjirokastrë	Përmet	227	Çarçove			185
37	Gjirokastrë	Përmet	229	Petran			367
38	Gjirokastrë	Përmet	231	Suke			398
39	Gjirokastrë	Mbyllur	211	Zagori	200	Libohovë	145
40	Gjirokastrë	Mbyllur	201	Q.Libohovë	200	Libohovë	171
41	Gjirokastrë	Mbyllur	208	Picar	202	Cepo	221
42	Gjirokastrë	Mbyllur	210	Antigon	206	Lunxheri	124
43	Gjirokastrë	Mbyllur	207	Odrie	206	Lunxheri	57
44	Gjirokastrë	Mbyllur	221	Qesarat	217	Krahës	283
45	Gjirokastrë	Mbyllur	215	Buz	220	Luftinje	193
46	Gjirokastrë	Mbyllur	218	Kurvelesh	222	Q Tepelenë	252
47	Gjirokastrë	Mbyllur	219	Lopes	222	Q Tepelenë	228
48	Gjirokastrë	Mbyllur	228	Frasher	230	Piskovë	127
49	Korçë	Korçë	240	Gore			514
50	Korçë	Mbyllur	241	Lekas	251	Voskopojë	105
51	Korçë	Mbyllur	244	Moglicë	251	Voskopojë	275
52	Korçë	Mbyllur	256	Barmash	255	Leskovik	67
53	Korçë	Mbyllur	258	Q Leskovik	255	Leskovik	126
54	Korçë	Mbyllur	257	Çlirim	259	Mollas	68
55	Korçë	Mbyllur	260	Novoselë	261	Q Ersekë	89
56	Korçë	Mbyllur	249	Vithkuq	245	Mollaj	377
57	Kukës	Kukës	286	Zapod			1108
58	Kukës	Kukës	289	Surroj			867
59	Kukës	Tropojë	301	Bytyç			612
60	Kukës	Tropojë	302	Fierzë			708
61	Kukës	Tropojë	303	Lekbibaj			753
62	Kukës	Tropojë	304	Llugaj			606
63	Kukës	Mbyllur	278	Kolsh	278	Kukës	39
64	Kukës	Mbyllur	280	Ujmisht	280	Bicaj	414
65	Kukës	Mbyllur	281	Gryk Caj	281	Bushticë	269
66	Kukës	Mbyllur	281	Kalis	281	Bushticë	216
67	Kukës	Mbyllur	289	Arren	289	Surroj	163
68	Kukës	Mbyllur	294	Gjinaj	294	Krume	26
69	Lezhë	Lezhë	315	Ungrej			612
70	Lezhë	Mbyllur	325	Selite	323	Kthelle	280
71	Lezhë	Mbyllur	322	Kacinar	319	Rrëshen	391
72	Shkodër	Shkodër	345	Pult			788
73	Shkodër	Shkodër	352	Shllak			434
74	Shkodër	Pukë	357	Iballë			706
75	Shkodër	Pukë	358	Fierzë			638
76	Shkodër	Mbyllur	349	Temal	336	Vau Dejës	341
77	Shkodër	Mbyllur	351	Vig Mnel	343	Hajmel	330
78	Shkodër	Mbyllur	348	Shosh	347	Shale	12
79	Shkodër	Mbyllur	363	Rrapë	354	Pukë	338
80	Shkodër	Mbyllur	356	Blerim	355	Fushë Arrëz	156
81	Shkodër	Mbyllur	360	Qafë- Mal	355	Fushë Arrëz	326
82	Shkodër	Mbyllur	361	Qelez	362	Qerret	430
83	Tiranë	Mbyllur	412	Sinaballaj	405	Rrogozhinë	190
84	Vlorë	Sarandë	434	Bashkia Konispol			414
85	Vlorë	Sarandë	441	Markat			444

VENDIM
Nr.418, datë 27.4.2009

PËR NJOHJEN DHE PËRDORIMIN E LETËRNJOFTIMIT SI DOKUMENT
IDENTIFIKIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3, 6 e 8 të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar, të pikave 4 e 5 të nenit 19 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare, për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet, publike dhe jopublike, vendase dhe të huaja, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do ta njohin si dokument identifikimi letërnjoftimin, sipas modelit të paraqitur në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Certifikata personale me fotografi do të përdoret si dokument identifikimi vetëm për shtetasit nën moshën 16 vjeç.

3. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, mbajnë shënim numrin personal dhe numrin e letërnjoftimit, si dhe mund të bëjnë fotokopje të letërnjoftimit të shtetasve, të cilëve u shërbejnë, nëse u nevojitet ky dokument si pjesë përbërëse e praktikës përkatëse.

4. Në rastet kur shtetasit nuk disponojnë letërnjoftim për arsye të justifikuara, lejohet përdorimi i certifikatës personale me fotografi, si dokument identifikimi, deri më 31 dhjetor 2009, në përputhje me dispozitat e parashikuara në aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore.

5. Ndaj punonjësve të institucioneve, publike dhe jopublike, vendase, në rast të moszbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë vendim, do të merren masa disiplinore fillimisht me gjobë, në vlerën e gjysmës së pagës, në rast përsëritjeje gjobë në vlerën e një page dhe nëse ripërsëritet pezullim nga detyra.

6. Ngarkohen të gjitha institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja Nr.1

Figure 1. Schematic representation of the experimental design. The subjects were divided into two groups: the control group and the experimental group. The control group was divided into two subgroups: the control group and the experimental group. The experimental group was divided into two subgroups: the control group and the experimental group.

REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA



mbiemri/surname

Sojli

emri/given name

Najada

shtrësia/nationality

Shqiptare/Albanian

vendlindja/place of birth

Tirana

date of birth

01-01-1980

date of issue

16-06-2004

10/00/2004
14:19:27 [https://www.pearsoned.com/authors/authority](#)

14B

nr. leternjoftim/card no.

200000907



gjinia/sex

F

data e skadimit/date of expiry

15-06-2014

nr. personal/personal no

1302031250

SPECIAL



I<ALB20000090741302031250<<<<<
8001014F1406159ALB<<<<<<<<<<7
SOJLI<<NAJADA<<<<<<<<<<<<<<<<<

Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr.64, datë 14.5.2009 në ligjin nr.10 123, datë 11.5.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër të huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEDB) për financimin e programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, malore”” në tekstin e marrëveshjes në pjesën e përkufizimeve, në nenin 4.1.2 dhe në shtojcën 1 emërtimi: “Fondi Shqiptar i Financimit të Zonave Malore (MAFF)” bëhet **“Kompania e Parë Financiare për Zhvillim (FAF)”**.

Në Fletoren Zyrtare nr.66, datë 14.5.2009 në ligjin nr.10 125, datë 11.5.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të Financave, Alpha Bank A.E. E Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si rregullues, institucioneve financiare, të listuara si huadhënësit fillestarë dhe Alpha Bank A.E., dega e Londrës, si agjent, për financimin e shpenzimeve kapitale për vitin 2009, në përputhje me strategjinë kombëtare për zhvillimin dhe integrimin e Shqipërisë””, në tekstin e marrëveshjes, Programi 1 “Huadhënësi Fillestar” bëhet:

Programi i Huadhënësit Fillestar

Emri i Huadhënësit Fillestar	Detyrimi Financiar i Instrumentit A (€)	Detyrimi Financiar i Instrumentit B (€)
Alpha Bank A.E., Dega Londër	50 000 000	0
Deutsche Bank AG, Dega Londër	14 000 000	0
Piraeus Banks S.A., Dega Londër	20 000 000	0
Banka Kombëtare Tregëtare SH.A.	11 000 000	0
Totali	95 000 000	0

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë

Hyri në shtyp më 20.5.2009
Doli nga shtypi më 20.5.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 38 lekë